

## **XV. KËSHILLI I SIGURIMIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

### **1. Përbërja e Këshillit të Sigurimit të Republikës së Maqedonisë**

**Këshilli i Sigurimit i RM-së përbëhet nga bartësit e funksioneve më të rëndësishme të Republikës:**

- **presidenti i Republikës;**
- **kryetari i Kuvendit;**
- **kryetari i Qeverisë;**
- **ministri që e udhëheq Ministrinë e Punëve të Brendshme;**
- **ministri që e udhëheq Ministrinë e Mbrojtjes;**
- **ministri që e udhëheq Ministrinë e Punëve të Jashtme;**
- **3 anëtarë që i emëron presidenti i Republikës.**

**Sipas amendamentit XIII të miratuar në vitin 2001, me rastin e emërimit të tre anëtarëve, presidenti i Republikës duhet të ketë parasysh faktin (ose sipas diksionit të Amendamentit – do të sigurojë) që përbërja e Këshillit, si tërësi, ta reflektojë në mënyrë përkatëse përbërjen e popullsisë në Republikën e Maqedonisë.**

**Kryetar i Këshillit të Sigurimit është presidenti i Republikës.**

### **2. Kompetenca e Këshillit të Sigurimit**

**Këshilli i Sigurimit i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe me mbrojtjen e Republikës dhe i paraqet propozime Kuvendit dhe Qeverisë.**

**PYETJE:**

- 1. Kush e përbën Këshillin e Sigurimit?**
- 2. Kush e udhëheq Këshillin e Sigurimit?**
- 3. Cilat janë kompetencat e Këshillit të Sigurimit?**